



- Të reja ▾Kush jemi ▾HistorikuShërbime ▾Baza ligjoreVendndodhjetVideoProgrami i transparencës ▾Kontakt
- Denonco Krimin KibernetikDrejtoritë Vendore ▾Policia Kufitare ▾Policia Rrugore ▾DonacionePolicimi në Komunitet ▾
- Përmbledhja JavorePër sinjaliziminTë Guximshëm Pa Armë

Breaking News: Drejtoria Vendore e Policisë Durrës – Vihen në pranga 3 shtetas
Drejtoria Vendore e Policisë Fier, gjatë 24 orëve të fundit
Drejtoria Vendore e Policisë Korçë, gjatë 24 orëve të fundit
Shkodër – Procedohen penalisht 3 shtetas, shpallet në kërkim 1 tjetër
Drejtoria Vendore e Policisë Elbasan, gjatë 24 orëve të fundit



06/06/2024

Dibër – Finalizohet Operacioni Policor I Koduar “Sllova”

Dibër

Falë ndërhyrjes në kohë të shërbimeve të Komisarariatit të Policisë Dibër, u parandalua një ngjarje e rëndë kriminale në familje.

Finalizohet operacioni policor i koduar “Sllova”, sekuestrohen 2 armë zjarri dhe municion luftarak.

Ushtroi dhunë fizike ndaj bashkëshortes dhe e kanosi se do ta vriste, me armë zjarri, arrestohet në flagrancë 50-vjeçari.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Dibër, pas njoftimit për një shtetas në fshatin Vleshë, që po dhunonte bashkëshorten dhe po e kanoste se do ta vriste me armë zjarri, që ai i mbante në banesë pa leje, në kuadër dhe të operacionit “Sundimi i Ligjit”, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar “Sllova”, ku u parandalua një ngjarje e mundshme kriminale.

Falë ndërhyrjes në kohë, shërbimet e Policisë kanë arrestuar në flagrancë shtetasin R.H., 50 vjeç, banues në fshatin Vleshë, njësia Administrative Sllovë.

Nga veprimet hetimore dyshohet se ky shtetas ka ushtruar dhunë fizike në mënyrë të përsëritur ndaj bashkëshortes së tij, si dhe e ka kanosur se do ta vriste me armë zjarri.

Gjatë kontrollit në ambientet e banesës së 50-vjeçarit, janë gjetur të fshehura në murin rrethues të banesës dhe u sekuestruan në cilësinë e provës materiale 1 armë zjarri automatik, 1 armë zjarri pushkë, 5 krehra dhe 267 municion luftarak.

Materialet i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > Arkiva
- > Akademia e Sigurisë
- > Ministria e Brendshme
- > Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- > Interpol
- > Europol
- > Misioni PAMECA V
- > SCPA
- > Projekti Trivalent